



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICË VERIJE OPSTINA SEVERNA MITROVICA	
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10
Nr. i faqeve Br. stranica No. of pages	14
N. D. G. B. L. P. Prot.	10-0361-0008632/25
Data Datum Date	02/06/2025

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore



Opština Mitrovica Sever – Municipality of Mitrovica North

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. _____. Data: 30/05/2025.

Mitrovicë Veriore.

RREGULLORE KOMUNALE NR. 02/2025

**PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË MITROVICËS
VERIORE**

Maj 2025, Mitrovicë Veriore

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 13 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Mitrovicës Veriut, Nr 10-030/01-0007269/24 të datës 28.06.2024, nenin 6, paragrafi 5, nenin 7, nenin 15 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, Ligjin Nr.06/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-179 për transportin rrugor, dhe nenin 5 të Ligjit për Shoqërit Tregtare Nr 06/L-016, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore, në mbledhjen e mbajtur 30.05.2025, miratoi këtë;

RREGULLORE PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit urban dhe urbano-periferik, transporti rrugor i udhëtarve, transporti i rregullt i udhëtarve, transportin për nevoja vetanake, transportin e veçantë dhe transportin e udhëtarve me “TAKSI” në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, si dhe kushtet për operimin e operatorëve të transportit rrugor.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore do të zbatohet në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, për të gjithë personat fizik dhe juridik që ushtrojnë veprimtarinë e transportit rrugor. Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të kësaj Rregullorëje është Drejtoria për Shërbime Publike (në vazhdim drejtoria)

Neni 3

Përgjegjësitë e komunës për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj

1. Kuvendi i Komunës, miraton rrjetin e linjave për transportin rrugor lokal.
2. Linjat e transportit publik të udhëtarëve në tërë territorin e Komunës, hapen dhe shpallën në përputhje me planin e transportit lokal.
3. Komuna, përmes Kryetarit të Komunës, mund të lidhë marrëveshje me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve.
4. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e komunës ushtrohet si:
 - 4.1. transport i rregullt i udhëtarëve

- 4.2. transport i lirë i udhëtarëve,
- 4.3. transportin taksi të udhëtarëve dhe
- 4.4. transportin e udhëtarve për nevoja vetanake
- 5. Drejtoria për Shërbime Publike, është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit dhe shërbimeve të parapara me nenin 1 të kësaj Rregullorëje.

Neni 4

Ushtrimi i veprimtarisë së operatorëve

- 1. Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve, stacioneve të autobusëve ushtrohet në bazë të licencës që u lëshohet operatorëve që i plotësojnë kushtet sipas ligjit dhe kësaj rregullorje.
- 2. Licenca është e domosdoshme për këto raste:
 - 2.1. transport të udhëtarëve;
 - 2.2. transport taksi;
 - 2.3. stacione të autobusëve;
- 3. Licenca lëshohet në vlefshmëri prej së paku pesë (5) vitesh.

Neni 5

Kushtet për operatorët e transportit rrugor

- 1. Operatorët e transportit që kryejnë veprimtari transporti në territorin e komunës, janë të detyruar të përdorin mjete të transportit, që janë teknikisht në gjendje të rregullt; të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportues;
 - 1.1 të plotësojnë evidenca statistikore, sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - 1.2 të mbajnë dokumentet përkatëse në automjetet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.
- 2. Për marrjen e licencës së transportit rrugor të udhëtarve, operatori duhet të plotësojë këto kushte:
 - 2.1 të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve në organin kompetent;
 - 2.2 të ketë së paku një automjet për bartjen e udhëtarëve në pronësi të operatorit me së paku (8+1) ulëse;
 - 2.3 të ketë personel të mjaftueshëm profesional për menaxhimin e kësaj veprimtarie;
 - 2.4 të ketë garazhden e cila i plotëson kushtet teknike;
 - 2.5 të ketë reputacion të mire

Neni 6

Obligimet e Operatorit

- 1. Operatori i transportit, i cili bën transportin e rregullt publik, duhet të marrë përsipër transportin e çdo udhëtari, që nuk janë të përjashtuar nga transporti sipas rregullave të veçanta.
- 2. Të gjithë autobusët me të cilët kryhet transporti publik i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull, sipas dispozitave ligjore.
- 3. Autobusi me të cilin kryhet transporti publik i udhëtarëve, duhet të ketë:
 - 3.1 firmën- respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore; -

- 3.2 numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes, ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit, të vënë në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës;
- 3.3 orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit, të vendosura në vend të dukshëm dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjës së duhanit.
4. Autobusi duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet higjieno—teknike, të përcaktuara me ligj.
5. Kur autobusi nuk bën transportin e rregullt të udhëtarëve, në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vihet mbishkrimi përkatës "Garazh" apo "Defekt".
6. Para fillimit të punës në linjën e caktuar, autobusi (automjet) duhet të plotësojë kushtet optimale për udhëtim.

II. TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE

Neni 7

Transport rrugorë i udhëtarëve.

1. Transporti rrugor i udhëtarëve ushtrohet si:
 - 2.1. transport i rregullt i udhëtarëve me autobus;
 - 2.2. transport i lirë i udhëtarëve me autobus;
 - 2.3. transport taksi i udhëtarëve;
 - 2.4. transport i udhëtarëve për nevoja vetanake.

Neni 8

Transport i rregullt i udhëtarëve

1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobus, kryhet në relacionet e caktuara (linja), sipas rendit të udhëtimit të përcaktuar dhe vërtetuar më parë, çmimit të caktuar e të shpallur dhe kushteve tjera të transportit.
2. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobus brenda territorit të Komunës mund të ushtrohet si:
 - 2.1. transport urban dhe urban-periferik;
 - 2.2. transport i veçantë i udhëtarëve;
 - 2.3. transport për nevoja vetanake.
3. Transporti urban dhe urban-periferik mund të kryhet si transport i rregullt dhe i njëjti mund të subvencionohet nga Komuna.
4. Komuna me akt nënligjor do të përcaktoj kushtet, procedurat, mënyrën e përzgjedhjes së relacioneve, tarifat si dhe do të përcaktoj linjat të cilat mund të subvencionohen.
5. Rrjeti i linjave urbane dhe urban-periferik si dhe numri i orareve miratohet nga Komuna.
6. Koha mbrojtëse është interval kohor në mes dy nisjeve nga e njëjta pikënisje dhe relacion.
7. Koha mbrojtëse në mes të dy nisjeve në të njëjtin relacion nuk mund të jetë më e shkurtër se 20 (njëzet) minuta distancë në mes veti.

Neni 9

Rendi i udhëtimit

1. Rendi i udhëtimit sipas kësaj Rregullorje është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor i cili përmban:
 - 1.1. emrin e operatorit;
 - 1.2. relacionin;
 - 1.3. llojin e transportit;
 - 1.4. radhitjen e vend-ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare në Km;
 - 1.5. kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend-ndalje;
 - 1.6. ditët e operimit, periudha kohore në të cilën mbahet linja;
 - 1.7. afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.
2. Rendi i udhëtimit vlen tri (3) vite.
3. Vazhdimin dhe vërtetimin e rendit të udhëtimit e bënë Drejtoria për Shërbime Publike
4. Transportuesi është i obliguar që transportin ta kryejë në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar në Drejtorinë përkatëse.

Neni 10

Fillimi i veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus

1. Operatori transportues obligohet që ta fillojë veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit, dhe atë nuk mund ta ndërpresë derisa të zgjatë afati i rendit të udhëtimit.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi mund të ndërpresë përkohësisht veprimtarinë, si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme, të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban dhe urbano-periferik.
3. Për ndërprerjen, nga paragrafi 2 i këtij neni, operatori transportues është i detyruar që të informoj organin i cili e ka vërtetuar rendin e udhëtimit, i cili organ do të lëshojë një vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.
4. Operatori transportues nuk mundet ta ndërpret (pezullojë) veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në linjë sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar pa lejen e Drejtorisë që e ka lëshuar rendin e udhëtimit.
5. Rendi i udhëtimit nuk mund të tjetërsohet, transferohet dhe as të jepet me qira.
6. Emri i operatorit i shënuar në rendin e udhëtimit duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe certifikatën e autobusit sipas licencës.
7. Gjërat e gjetura në automjetet i dorëzohen personelit të automjetit, i cili për këtë lëshon vërtetim me përshkrimin e shkurtër të sendeve të gjetura.
8. Nëse pronari i gjësendeve të gjetura nuk gjindet gjatë vozitjes, personeli i automjetit ato ia dorëzon menjëherë shërbimit përkatës të transportuesit.
9. Transportuesi detyrohet që gjësendet e gjetura në afat prej 2 ditësh, t'ia dorëzojë policisë.

Neni 11

Revokimi i rendit të udhëtimit

1. Rendi i udhëtimit do të revokohet nga organi që e ka lëshuar atë në rastet kur:
 - 1.1 Në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë;
 - 1.2 brenda një (1) muaji kalendarik pa miratimin e Drejtoris përkatëse që e ka lëshuar atë nuk e mban nisjen tri (3) herë;
 - 1.3 kur operatori vepron në kundërshtim me ligj dhe aktet nënligjore.
2. Vazhdimin dhe vërtetimin e rendit të udhëtimit e bënë Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 12

Përcaktimi i çmimorës

1. Operatori përcakton çmimoren e cila duhet të vendoset në autobus i cili qarkullon në atë linjë.
2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimorës nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 13

Bileta

1. Çdo udhëtar duhet të pajiset me biletë për relacion të caktuar:
2. Udhëtari në automjet ka për detyrë ta tregojë biletën e udhëtimit me kërkesën e pjestarit të personelit të operatorit transportues, respektivisht të inspektoriatit Komunal.
3. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit apo leje tjetër valide të udhëtimit.
4. Transportuesi është i obliguar që të japë biletën e udhëtimit, në bazë të së cilës udhëtari fiton të drejtën për udhëtim, si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçantë për të.
5. Bileta duhet të përmbajë:
 - 5.1. relacionin
 - 5.2. çmimin
 - 5.3. numrin serik,
 - 5.4. emrin e operatorit të transportit,
 - 5.5. datën dhe kohën e nisjes,
 - 5.6. dëshmi për bagazhin e udhëtarit

Neni 14

Transporti i veçantë

1. Transport i veçante i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët tjerë, në relacion të caktuar dhe në bazë të lejës së veçantë.
2. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti si
 - 2.1 nxënësve dhe studentëve, nga vendbanimi deri te institution shkollor dhe anasjelltas,
 - 2.2 punëtorëve, nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas dhe
 - 2.3 invalideve dhe personave me përkujdesje të veçantë,
3. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të kontratës e cila duhet të ketë:

- 3.1 relacionin,
 - 3.2 listen e udhëtarëve,
 - 3.3 çmimin e transportit,
 - 3.4. vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve dhe
 - 3.5 kohën, gjatë së cilës kryhet transporti.
4. Kontratën nga paragrafi 2 i këtij neni e bënë operatori transportues paraprakisht i cili është licencuar nga Ministria, dhe porositësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve ku porositësi është njëkohësisht edhe pages i transportit nese transporti kryhet Brenda dy e më teper komunave, ndërsa nese transporti kryhet brenda territorit të një komune e bënë operatori i licencuar nga komuna.
5. Lejen për transport, sipas këtij neni, e lëshon organi kompetent komunal nese transporti kryhet Brenda një komune.
6. Lejet sipas këtij neni nuk përmbajnë rendin e udhëtimit dhe çmimoren e përcaktuar sipas kesaj Rregullore.
7. Në autobusë në pjesën e përparme në vend të dukshëm duhet të jetë mbishkrimi “Transport i veçantë.
8. Operatori i transportit është i detyruar që të gjithë udhëtarët t'i pajis me kartelë identifikimi

Neni 15

Transporti për nevoja vetanake

1. Transporti për nevoja vetanake të udhëtarëve janë operacione që kryhen për qëllime jo-komerciale dhe jo-fitimprurëse nga një person fizik ose juridik, për te cilat:
- 1.1. aktiviteti i transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për atë person fizik ose juridik
 - 1.2. mjetet e përdorura janë pronë e atij personi fizik ose juridik, ose kanë qenë objekt i një kontrate mbi qiranë dhe drejtohen nga një anëtar i stafit të personit fizik apo juridik ose personi fizik ose vetë nga personeli i punësuar nga ai, ose të vënë në dispozicion të ndërmarrjes nën një detyrim kontraktual.
2. Veprimtaria e transportit për nevoja vetanake i nënshtrohet marrjes së një autorizimi/certifikate, të lëshuar nga Komuna, varësisht nga kompetencat që ushtrojnë në bazë të ligjit.
3. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja vetanake duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë i vërtetuar nga ana e pronarit (operatorit), ose ndonjë dëshmi tjetër për të drejtën e transportit të këtyre punëtorëve ose personave.
4. Në të dy anët, ose në këndin e djathtë të poshtëm të xhamit mbrojtës të autobusi, me të cilët kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja vetanake, duhet të jetë i shënuar mbishkrimi “Transporti për nevoja vetanake”.

Neni 16

Stacionet e autobusëve

1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve bëhet në stacionet e autobuseve dhe në vendndaljet e destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit.
2. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vendndaljet, të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

3. Drejtoria me rend të udhëtimit e cakton numrin e stacioneve që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit të udhëtarëve.
4. Stacionet dhe vendndaljet e autobusëve në linjat e transportit publikë me plan i cakton Drejtoria për Shërbime Publike.
5. Stacionet dhe vendndaljet për marrjen dhe zbritjen e udhëtarëve duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, doemos duhet të kenë sipërfaqe përkatëse të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit.
6. Në rrugët publike, sipërfaqja për ndaljen e automjetit parimisht duhet të jetë e ndertuar jashtë shiritit të rrugës, në pjesë të ndarë të rrugës.
7. Sipërfaqja që shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti, në rrugë apo në vendbanim, duhet të jetë e shtruar me asfalt, pllaka ose të jetë e betonuar.
8. Për rregullimin e stacioneve dhe vendndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave, kujdeset Drejtoria përkatëse.
9. Drejtoria përkatëse, mund të bëjë shkëputjen ose transferin e stacionit dhe të vendndaljes, nese kjo është në interes të organizimit me të mirë dhe të sigurtë në trafik.
10. Stacioni apo vendndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është me i gjatë se 15 minuta, duhet të ketë nenpullazet.
11. Drejtuesi i automjetit në transportin linjor të udhëtarëve, nuk mund të ndalë-parkojë automjetin në stacionin e nisjes me gjatë se 10 minuta para nisjes.

Neni 17

Rregullat për personelin

1. Automjetet me të cilat bëhet transporti rrugor i udhëtarëve në trafikun urban dhe urbano-periferik, duhet t'i plotësojnë kushtet teknike dhe tekniko shfrytëzuese të rregullsisë së automjeteve.
2. Automjetet duhet të kenë urdhëresë udhëtimi, të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.
3. Çdo automjet në transportin rrugor të udhëtarëve, duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës funksional, barnatore manual, çekiçi për thyerjen e xhamave në rast rreziku dhe pajisjet tjera.
4. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, uleset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve dhe shenjat e dyerve të hyrjes dhe të dalje
5. Në automjetet e transportit rrugor të udhëtarëve ndalohet vendosja e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter pornografik.
6. Automjetet patjetër duhet të ndalen në të gjitha stacionet, përkatësisht vendndaljet e linjave të tyre.
7. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit.
8. Vetëm personeli i automjetit hap dhe mbyll dyert e automjetit.
9. Personeli i automjetit nuk guxon të japë shenjë për nisje, derisa të konstatoje së janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve. Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbajë rrobat (uniformen) zyrtare dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.
10. Udhëtarët hyjnë në automjet përmes dyerve të shënuara për hyrje dhe zbresin përmes dyerve të shënuara për dalje.

11. Personat me nevoja të veçanta, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri në 5 vjec, inspektorët e trafikut, policët në uniforme dhe personat me autorizime të veçanta, mund të hyjnë në dyert e daljes.

Neni 18 **Caktimi i rregullave për udhëtarë**

1. Gjatë transportit, ndalohet:

- 1.1 pengimi i personelit të automjetit në kryerjen e detyrës;
- 1.2 pirja e duhanit në automjet;
- 1.3 hyrja në automjet me armë, përveç personave të autorizuar;
- 1.4 futja në automjet e gjësendeve, të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqëtesojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin;
- 1.5 futja në automjet e materialeve ndezëse dhe e mjeteve eksplozive;
- 1.6 hyrja në automjet në gjendje të dehur;
- 1.7 shqëtesimi i udhëtareve me këndim, me muzikë, me britmë, me shprehje e sjellje të papërgjegjshme;
- 1.8 hedhja e mbeturinave dhe pështymja në automjet;
- 1.9 udhëtari i cili edhe pas verejtjes, kryen ndonjerën nga veprimet e cekura në këtë nen, largohet nga automjeti.

III. TRANSPORTI I UDHËTARËVE ME "TAKSI"

Neni 19 **Transporti i udhëtarve me "Taksi"**

1. Transporti Taksi është transporti publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit sipas çmimoreve të shërbimeve.
2. Çmimorja duhet të jetë e vërtetuar nga Drejtoria për shërbime Publike dhe e vendosur në vend të dukshëm brenda në automjet.
3. Taksimetri duhet të jetë në gjendje të rregullt, atestuar dhe vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër si dhe i vendosur në vend të dukshëm në automjet.
4. Transportuesi që kryen transport taksi të udhëtarëve është i detyruar ti jep atij dëshminë për shërbimin e bërë e cila dëshmi përmban: regjistrimin e automjetit, relacionin, kohën e transportit, çmimin dhe nënshkrimin e transportuesit.

Neni 20

Kryerja e transportit taksi

1. Transporti taksi mund të kryhet vetëm me automjet me pesë (5) katër plus një (4+1) ulëse dhe i cili i ka së paku katër dyer. Dhe, për motoçikleta një plus një (1+1) ulëse por vetëm brenda qytetit.
2. Automjeti sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio ose gjysme-rimorkio).
3. Drejtuesi i automjetit “taksi” nuk mund të qëndroj dhe as të marr udhëtarë në territorin e komunës në të cilën nuk është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë taksi.
4. Transporti “Auto-taksi” zhvillohet brenda territorit të komunës në të cilën është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë taksi, transporti “Auto-taksi” mund të kryhet edhe jashtë territorit të komunës, në qoftë se transporti fillon në territorin e komunës në të cilën është i licencuar.
5. Transporti i udhëtarëve me taksi në linjë të rregullt është i ndaluar.

Neni 21

Kushtet për lëshimin e licencës

1. Personi i cili dëshiron të pajiset me licensë pune taksi përpos kushteve të parapara me dispozitat e kësaj Rregullorë dhe legjislacionin në fuqi duhet ti plotësoj edhe këto kushte;
 - 1.1 të jetë banor i Komunës së Mitrovicës së Veriut.
 - 1.2 të ketë selin e biznesit brenda territorit të Komunës së Mitrovicës së Veriut.
 - 1.3 të ketë numrin e nevojshëm të personelit dhe të automjeteve.
 - 1.4 të ketë së paku 5 vite përvojë në drejtimin e automjetit.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë taksi lëshohet për pesë (5) vite me mundësi vazhdimi.

Neni 22

Tarifat për licencim

1. Biznesi Individual (Personi fizik) që ushtron veprimtarinë Taxi, që ka të regjistruar vetëm një veturë për këtë veprimtari , pas plotësimit të kushteve të parapara me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi do të pajiset me licensë, në kohëzgjatje për 5 vite, me mundësi vazhdimi
2. Biznesi Individual (Personi fizik) që ushtron veprimtarinë Taxi, sipas pikes 1 të këtij neni, duhet të paguaj liencën prej 300 euro (5euro në muaj për 5 vjet), të cilën shumë duhet ta paguaj në momentin e licencimit.
3. Biznesi Individual (Personi fizik) që ushtron veprimtarinë Taxi,në pronësi të gjinisë femërore, të pajisuara me licensë sipas pikes 1 të këtij neni, lirohen nga kjo tarifë në vitin e pare.
4. Shoqëritë tregtare qe ushtrojn veprimtarinë Taxi, e që kanë të regjistruar dy apo më tepër vetura për këtë veprimrtari pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 21 të Kësaj rregullorje do të pajiset me licensë për 5 vite me mundësi vazhdimi.

5. Shoqëritë tregtare që ushtrojnë veprimtarinë Taxi, sipas pikes 4 të këtij neni, duhet të paguajnë licencën në shumën prej 1,000 Euro (16.667 Euro në muaj për 5 vite), të cilën shumë duhet ta paguaj në momentin e licencimit.

Neni 23

Ndërprerja e ushtrimit të veprimtarisë Taksi të udhëtarëve

1. Biznesi Individual (Personi fizik) që ushtron veprimtarinë Taxi, që ka të regjistruar vetëm një veturë për këtë veprimtari mund të ndërprejë ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, në kohën e:

- 1.1. shfrytëzimit të pushimeve të parapara sipas ligjeve në fuqi;
- 1.2. aftesimit profesional ose kryerjes së funksionit publik;
- 1.3. riparimit të veturës me të cilin ushtron veprimtarinë e transportit taksi të udhëtarëve, në kohëzgjatje prej 30 ditësh gjatë vitit kalendarik;

1.4. paraburgimit ose vuajtjes së dënimit me burg, në kohëzgjatje deri në gjashtë (6) muaj, si dhe për kohën sa zgjat procedura e hetuesisë, përkatësisht masa e ndalimit të drejtimit të veturës.

2. Kërkesën për ndërprerjen e përkohshme të ushtrimit të veprimtarisë, personi fizik ia parashtron drejtorisë kompetente, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e paraqitjes së rrethanave nga nenet paraprake.

3. Pas kërkesës nga paragrafi 2. i këtij neni, drejtuesi i taksisë menjëherë është i obliguar të kthejë licencën për ushtrimin e veprimtarisë, e cila do të mbetet në drejtori për atë kohë sa zgjat masa e përkohshme.

4. Drejtuesi i taksisë është i obliguar që të rifillojë punën në afat prej tri (3) ditësh nga dita e ndërprerjes së arsyeve për të cilat është lejuar ndërprerja e përkohshme e ushtrimit të veprimtarisë.

5. Biznesi Individual (Personi fizik) që ushtron veprimtarinë Taxi, që ka të regjistruar vetëm një veturë për këtë veprimtari, në rast të ndërprerjes së veprimtarisë, obligohet t'i kthejë licencën dhe certifikatën e veturës për ushtrimin e kësaj veprimtarie drejtorisë kompetente.

6. Veprimtaria për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve ndërpritet me fshirjen nga regjistri i taksistëve aktiv, por mbetet në regjister historik.

Neni 24

Licenca për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve humbë vlerën

1. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve humb vlerën kur:

- 1.1. operatori falimenton (nëse vërtetohet me vendim të autoriteteve kompetente);
- 1.2. mbaron afati i vlefshmërisë së saj;
- 1.3. me rastin e vdekjes së ushtruesit të veprimtarisë

2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve hiqet nga Drejtoria e cila e lëshon atë, kur: vërtetohet se operatori ka humbur njerëz nga kushtet e percaktuara me nenet paraprake të kësaj rregulloreje, me rastin e inspekimit vërtetohet se mbajtësi i licences shkel detyrimet e percaktuara me këtë rregullore.

3. Vendimi merret nga drejtoria kompetente që ka lëshuar licencën, pas deshmisë së provave dhe argumentimit sipas kësaj rregulloreje.

4. Drejtoria e Inspeksionit mund të inicioje revokimin e licencës në rast se personi përgjegjës i personit juridik dhe personi fizik, bëjnë përsëritje disa here të shkeljeve (kundervajtjeve).

IV. MBIKËQYRJA

Neni 25 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në transportin rrugor të udhëtarëve brenda territorit të komunës, e bën Drejtoria kompetente për shërbime publike
2. Inspektori i komunikacionit rrugor është i autorizuar:
 - 2.1 të bëjë kontrollin e operatorëve të transportit rrugor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, në bazë të licencave, të vërtetoje identitetin e operatorit transportues, personelit vozitës dhe të personave të tjerë përgjegjës për kryerjen e transportit;
 - 2.2 të urdhëroje menjanimin e lëshimeve dhe mungesave në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë rregullore për kryerjen e transportit të udhëtarëve;
 - 2.3 të përjashtojë nga qarkullimi automjetin, me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, të caktojë vendparkimin, t'ia marre lejën e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh.
3. Nëse të njejtin operator të transportit i shqiptohet masa e gjobës mandatore për herë të dytë, për shkak të përcaktuara në paragrafin 2, pika 3, të këtij neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në 5 ditë.
4. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi, atij i merret shenja "TAXI" dhe numri i evidencës i regjistrimit të qarkullimit.
5. Me kalimin e afatit të masës, nga paragrafi 2, pika 2.3 dhe paragrafi 3 i këtij neni, inspektori ia kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra, qoftë vetë apo përmes organit i cili ka lëshuar këto.
6. Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet, në shpenzime të mbajtësit të licencës, në vende të caktuara për keto raste.

V.E DREJTA E ANKESËS

Neni 26 E drejta për ankesë

1. Kundër secilit vendim përfundimtar të nxjerrë sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Kundër vendimit të lëshuar nga inspektori, mundë të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktit administrative.
3. Organ epror që i shqyrton ankesat është Komisioni i ankesave i themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës, për vendimet që merren nga ana e Komunës së Mitrovicës Veriore.
4. Organi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni me Akt përkatës nënligjor përcakton përbërjen e Komisionit dhe mandatin e antarve të Komisionit. Puna dhe procedura e

komisionit të ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

VI. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 27

Dispozitat Ndëshkimore

Inspektorët Komunal të trafikut, përveq masave të parapara me dispozitat e ligjit për Transportin rrugor, shqipëtojnë gjoba mandatore në pajtim me dispozitat e ligjit për kundërvajtje ndaj operatorëve dhe personave të cilët, në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarve.

Neni 28

Masat Mbrojtëse

Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bën përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit prej 6 deri në 12 muaj.

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 29

Dispozitat kalimtare dhe te fundit

Për të gjitha çështjet tjera që nuk janë të parapara me këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi transportin rrugor Nr.04-/L-179 dhe Ligjit për Kundërvajtje Nr.05-/L-087 dhe akteve Nënligjore të ligjeve përkatëse.

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesën organet kompetente Drejtoria për Shërbime Publike dhe Policia e Kosoves.

Neni 30

Nxjerrja e akteve

Operatorët e transportit obligohen që në afat prej 6 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 31
Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Mitrovicë Veriore

Nedžad UGLJANIN



Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës

Dorëzohet:


1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPL

1x1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Të gjitha Drejtorive



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Erden Atiq, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Veriut Nedžad Ugljanin, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Rregullore Komunale nr. 02/2025 për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Veriut, datë 02.06.2025

I nderuar kryetar Atiq,
I nderuar kryesues Ugljanin

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 03.06.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Rregulloren Komunale nr. 02/2025 për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Veriut, datë 02.06.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave:

KONFIRMON

Rregulloren Komunale nr. 02/2025 për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Veriut, datë 02.06.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Vendimi i lartcekur është në përputhje me Ligjin Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor dhe me aktet tjera nënligjore në fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mbetet në dispozicion të Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.